

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **SPITALI REGJIONAL - PRIZREN**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **220/70010-26-1932-2-1-1**

Sa i përket tenderit për **Mirëmbajtja e rregullt dhe servisimi i ashensorëve në Spitalin e Përgjithshëm të Prizrenit**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	" EJONA " SH.P.K.
NUI	810089913
Adresa	Zahaq
Vendi	Peja
Kodi postar	30000
Numri Telefonit	049137987
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Ejona Prelvukaj
Adresa elektronike	info@ejona.com
Data e parashtrimit të ankesës	13.07.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Mirëmbajtja e rregullt dhe servisimi i ashensorëve në Spitalin e Përgjithshëm të Prizrenit

29.04.2026 Njoftimi për Kontratë

08.06.2026 13:00 Afati për dorëzimin e ofertave/kërkesës për pjesëmarrje

26.06.2026 B58 Njoftim mbi vendimin e autoriteti kontraktues

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

30.06.2026 Kërkesë për Rishqyrtim nga EJONA SH.P.K

02.07.2026 Refuzimi i kërkesës për Rishqyrtim

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e

PRETENDIMI 1) Lista e punëve të ngjashme / referencat

Dispozitat e shkelura:

- **LPP, Neni 7** Barazia në trajtim / Jo-diskriminimi.
- **LPP, Neni 59.4** Tenderi konsiderohet i përgjegjshëm vetëm nëse është në përputhje me të gjitha kërkesat e njoftimit dhe dosjes së tenderit.
- **LPP, Neni 60.1** Kontrata i jepet vetëm tenderit të përgjegjshëm.
- **LPP, Neni 69** Dëshmimi i aftësisë teknike dhe/ose profesionale.
- **LPP, Neni 72.3** Dokumentet që mungojnë mund të plotësohen vetëm nëse ekzistenca e tyre ka qenë e fiksuar para afatit për dorëzim të tenderëve.
- **Dosja e Tenderit, Kërkesa 1 dhe Dëshmia 1** Kontratat e natyrës së ngjashme të përfunduara me sukses dhe referencat/certifikatat përkatëse.
-

PRETENDIMI 2) Mosdeklarimi i nënkontraktimit për trupin inspektues

Dispozitat e shkelura:

- **LPP, Neni 7** Barazia në trajtim / Transparenca.
LPP, Neni 30 Nën-kontraktimi – Tenderuesi duhet të tregojë në tenderin e tij ndonjë pjesë të kontratës që ka për qëllim ta nënkontrakttojë palëve të treta dhe secilin nënkontraktues të propozuar.
- **LPP, Neni 59.4** Përgjegjshmëria e tenderit sipas kërkesave të dosjes.
- **LPP, Neni 60.1** Dhënia e kontratës vetëm tenderit të përgjegjshëm.
- **LPP, Neni 69** Dëshmimi i kapacitetit teknik/profesional.
Rregullorja Nr. 001/2022, pika 17.19 AK duhet të deklarojë në DT që OE-të duhet të tregojnë në tenderin e tyre çdo pjesë të kontratës që kanë për qëllim ta nënkontrakttojnë te palët e treta dhe secilin nënkontraktues të propozuar. Secili nënkontraktor i propozuar duhet të përmbushë kërkesat e përshtatshmërisë dhe të dorëzojë dëshmitë mbi përmbushjen e tyre. Në rast se OE nuk ka deklaruar nënkontraktim në tenderin e tij, gjatë ekzekutimit të kontratës nuk i lejohet të nënkontrakttojë ndonjë pjesë të kontratës.
- **LPP, Neni 72.3** Moslejimi i plotësimeve substanciale pas afatit të ofertimit.
- **Dosja e Tenderit, pika 12.1 – Nënkontraktimet** OE duhet të deklarojë çdo pjesë të kontratës që do ta nënkontrakttojë.
- **Kushtet e Përgjithshme të Kontratës, Neni 4.1 dhe 4.2** Nënkontraktimi duhet të jetë me marrëveshje të shkruar dhe identiteti i nënkontraktuesit duhet të bëhet i ditur me rastin e dorëzimit të ofertës.
- **Dosja e Tenderit, Kërkesa 7 dhe Dëshmia 7** Angazhimi i trupit inspektues të autorizuar për kontrollin dhe certifikimin e ashensorëve.
-

PRETENDIMI 3) Konfidencialiteti i paarsyetuar dhe mosdhënia e dokumenteve

Dispozitat e shkelura:

- **LPP, Neni 7** Transparenca dhe trajtimi i barabartë.
- **LPP, Neni 10 dhe Neni 11** Qasja në dokumente dhe trajtimi i informatave sekrete afariste.
- **LPP, Neni 108/A** E drejta për kërkesë për rishqyrtim.
- **Rregullorja Nr. 001/2022, pika 7.6.1** AK nuk klasifikon informatë si sekret afarist nëse OE nuk e ka plotësuar Aneksin 3 dhe nuk ka paraqitur fakte/argumente për dëmin material.
- **Rregullorja Nr. 001/2022, Neni 97.1 pika c** Moslejimi/neglizhimi i qasjes në dokumente zyrtare sipas kërkesës me shkrim.

PRETENDIMI 4) Dinamometri / mungesa e dëshmisë për shfrytëzim

Dispozitat e shkelura:

- **LPP, Neni 7** Trajtimi i barabartë dhe transparenca.
- **LPP, Neni 59.4** Tenderi duhet të jetë në përputhje me kërkesat e dosjes.
- **LPP, Neni 60.1** Kontrata i jepet vetëm tenderit të përgjegjshëm.
- **LPP, Neni 69** Dëshmimi i aftësisë teknike/profesionale dhe pajisjeve teknike.
- **LPP, Neni 72.3** Dokumentet substanciale nuk mund të plotësohen pas afatit nëse nuk ekzistonin paraprakisht.
- **Dosja e Tenderit, Kërkesa 8 dhe Dëshmia 8** – Dinamometri duhet të dëshmohet me faturë, DUD doganor mbi blerje ose kontratë për marrje në shfrytëzim gjatë kohës së servisimit.

PRETENDIMI 5) Oferta financiare me çmime jo-normalisht të ulëta

Dispozitat e shkelura:

- **LPP, Neni 7** Barazia në trajtim dhe transparenca.
- **LPP, Neni 59** Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve.
- **LPP, Neni 61** Tenderët jo-normalisht të ulët.
- **Dosja e Tenderit, Specifikimet Teknike / Përshkrimi i Çmimeve**
Çmimet duhet të mbulojnë furnizimin, montimin, mirëmbajtjen, servisimin dhe garancionin sipas kërkesave të përcaktuara.

PRETENDIMI 6) Oferta e OE UP LIFT është dashur të shpallet e papërgjegjshme

Dispozitat e shkelura:

- **LPP, Neni 59.4** Tenderi i papërputhshëm me kërkesat e dosjes nuk është i përgjegjshëm.
- **LPP, Neni 60.1** Kontrata mund t'i jepet vetëm tenderit të përgjegjshëm.
- **Dosja e Tenderit, pika 27.2** Tenderi është i përgjegjshëm vetëm nëse plotëson kërkesat administrative, teknike dhe kriteret e

përzgjedhjes.

- **Dosja e Tenderit, pika 29.1** Tenderi i papërgjegjshëm refuzohet dhe nuk mund të bëhet i përgjegjshëm më vonë.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

ARGUMENTET SIPAS PRETENDIMEVE

PRETENDIMI 1) Lista e punëve të ngjashme / referencat e paplota dhe të pavlefshme

Në Dosjen e Tenderit është kërkuar që Operatori Ekonomik të ofrojë dëshmi/listë të kontratave të natyrës së ngjashme, **të përfunduara me sukses në tri vitet e shkuara**

nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, në shumë jo më pak se **315,000.00 euro**.

Po ashtu, si dëshmi është kërkuar së paku një referencë/certifikatë mbi përfundimin e suksesshëm të punëve nga punëdhënësi.

Duke marrë parasysh se Njoftimi për Kontratë është publikuar më **29.04.2026**, periudha relevante për kontrata të përfunduara me sukses është periudha **29.04.2023 - 29.04.2026**.

Nga lista e punëve të dorëzuar nga OE **UP LIFT**, rezulton se ky operator ka paraqitur disa kontrata, mirëpo nuk ka dorëzuar dokumente mbështetëse/referenca për shumicën prej tyre, ndërsa për disa kontrata ka mospërputhje serioze ndërmjet listës dhe dokumenteve të dorëzuara.

Konkretisht:

1. **Kontrata me Komunën e Prishtinës – Kuvendi Komunal**
OE **UP LIFT** e ka paraqitur këtë kontratë si të përfunduar më **15.05.2025(pas datës së njoftimit për kontrat)**, në vlerë **324,809.50 euro**.
2. Mirëpo, në kontratën e bashkangjitur, kjo kontratë është ende aktive deri më **01.08.2026**.

Dosja e Tenderit kërkon kontrata të **përfunduara me sukses**, jo kontrata aktive

apo në realizim.

3. Poashtu, OE nuk ka bashkangjitur asnjë dëshmi të përfundimit të kontratës, vetëm kontratën e nënshkruar.
4. Prandaj, kjo kontratë nuk mund të merret si dëshmi valide për përmbushjen e kriterit.

Kontrata me VIVA FRESH SH.P.K.

5. Në listë është paraqitur kontrata në vlerë **73,800.00 euro**, me periudhë **01.05.2023 - 30.04.2026 (pas datës së njoftimit për Kontrat)**.
Ndërsa, referenca mban datën **10.05.2022**, dhe kjo referencë nuk mund të merret si e vlefshme.

6.

7. Kontrata me Këshillin Gjyqësor të Kosovës

Në listë është paraqitur kontrata në vlerë **50,000.00 euro**, me periudhë **24.08.2022 - 25.08.2024**. Për këtë kontratë nuk është dorëzuar asnjë dokument mbështetës/referencë.

Pa referencë nuk mund të verifikohet realizimi i suksesshëm, fushëveprimi dhe vlera e pranueshme.

8.

9. Kontrata me Këshillin Prokurorial të Kosovës

Në listë është paraqitur kontrata në vlerë **40,000.00 euro**, me periudhë **17.08.2022 - 17.08.2024**. Edhe për këtë kontratë nuk është dorëzuar asnjë dokument mbështetës/referencë.

Prandaj, kjo kontratë nuk mund të merret si dëshmi valide.

10.

11. Kontrata me BTP HOLDING SH.P.K.

Në listë OE UP LIFT e ka paraqitur këtë kontratë me datë përfundimi **29.02.2024** dhe vlerë **240,000.00 euro**. Mirëpo, referenca e dorëzuar për këtë kontratë është e datës **20.09.2022**.

Kjo krijon mospërputhje të qartë ndërmjet listës së punëve dhe referencës së dorëzuar. Pasi që referenca është e vitit 2022, atëherë ajo është jashtë periudhës së kërkuar dhe nuk mund të përdoret për përmbushjen e kriterit.

Poashtu, në qasjen tonë të dokumentave të UP LIFT në një aktivitet tjetër, kjo kontratë është deklaruar si e përfunduar më 30.03.2023 dhe është bashkangjitur e njejta referencë.

12.

13. Kontrata me Spitalin e Përgjithshëm Prizren

Në listë është paraqitur kontrata në vlerë **104,500.00 euro**, me periudhë **29.02.2024 - 28.02.2026**. Mirëpo, edhe për këtë kontratë nuk është dorëzuar referencë/certifikatë për përfundimin e suksesshëm.

14. OE UP LIFT ka dërguar edhe referenca që nuk janë paraqitur në listën e punëve të përfunduara, mirëpo të njejta figurojnë si kontratat të vjetra përkatësisht:

FIDOLA : referenca mban datën **12.05.2022**

ENG OFFICE: projekt i përfunduar më **27.03.2022 (deklaruar nga vetë OE në një aktivitet të vitit 2023, ku ka bashkengjitur të njëjtën referencë)**.

15. **POZHEGU BROTHERS**: projekt i përfunduar më **24.12.2021 (deklaruar vetë nga OE në aktivitet të vitit 2023, ku ka bashkengjitur të njëjtën referencë)**

16.

Prandaj, OE UP LIFT nuk ka dëshmuar me dokumente valide se i plotëson kontratat e natyrës së ngjashme në vlerë jo më pak se **315,000.00 euro**, të përfunduara me sukses dhe

të mbështetura me referenca/certifikata përkatëse para datës së publikimit të njoftimit për kontrat.

Lista e kontratave nuk mjafton vetvetiu, ku në të njëjtën ky OE ka dhënë informata të rrejshme.

Dosja e Tenderit ka kërkuar edhe referenca/certifikata mbi përfundimin e suksesshëm të punëve. Në mungesë të tyre, Autoriteti Kontraktues nuk ka pasur bazë objektive për ta shpallur ofertën e OE **UP LIFT** të përgjegjshme.

Dokumentet shtesë ku vërtetojnë argumentet tona për dokumentet e njëjta të paraqitura në aktivitet prokurimi të datës 19.05.2023, do i ngarkojmë tek dokumentet tjera.

PRETENDIMI 2) Mosdeklarimi i nënkontraktimit për trupin inspektues të autorizuar

Në Dosjen e Tenderit është kërkuar që OE të angazhojë kompani të autorizuar/trup inspektues nga institucionet e Republikës së Kosovës, për kontrollin e ashensorëve dhe lëshimin e certifikatës së konformitetit për përdorim të sigurt të ashensorëve për secilin ashensor. Si dhe në paramasë është pozicion i veçantë kryerja e këtij shërbimi nga një kompani e licensuar për certifikim.

Ky shërbim nuk mund të kryhet nga çdo operator ekonomik, por vetëm nga një subjekt i autorizuar/licencuar për këtë veprimtari i cili nuk mund të jetë edhe mirëmbajtës/instalues i ashensorëve, por vetëm trup certifikues.

Nëse OE **UP LIFT** nuk është vetë trup inspektues i autorizuar për kryerjen e kontrollit dhe certifikimit të ashensorëve, atëherë ai domosdoshmërisht duhet të angazhojë një subjekt tjetër të autorizuar për këtë pjesë të kontratës.

Sipas **Nenit 30 të LPP-së** dhe **pikës 17.19 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik**, tenderuesi duhet të deklarojë në tender çdo pjesë të kontratës që ka për qëllim ta nënkontraktojë te palët e treta, si dhe secilin nënkontraktor të propozuar. Secili nënkontraktor duhet të përmbushë kërkesat e përshtatshmërisë dhe të dorëzojë dëshmitë përkatëse.

Në rastin konkret, OE **UP LIFT** nuk e ka deklaruar nënkontraktimin për trupin inspektues të autorizuar.

Nuk është treguar se cili subjekt konkret do të bëjë kontrollin dhe certifikimin e ashensorëve dhe nuk janë dorëzuar dëshmitë e përshtatshmërisë për atë subjekt.

Deklarata e përgjithshme se OE do të angazhojë kompani të autorizuar nuk e zëvendëson deklarin formal të nënkontraktorit.

Nëse një pjesë e kontratës do të kryhet nga një palë e tretë, ajo palë duhet të identifikohet në ofertë.

Mosdeklarimi i këtij subjekti e bën të pamundur verifikimin e kapacitetit, licencimit dhe përshtatshmërisë së tij.

Për më tepër, sipas pikës 17.19 të Rregullores, nëse OE nuk ka deklaruar nënkontraktim në tenderin e tij, gjatë ekzekutimit të kontratës nuk i lejohet të nënkontraktojë ndonjë pjesë të kontratës.

Prandaj, oferta e OE **UP LIFT** është dashur të konsiderohet e papërgjegjshme edhe për shkak të mosdeklarimit të nënkontraktimit për trupin inspektues të autorizuar.

PRETENDIMI 3) Konfidencialiteti i paarsyetuar dhe mosdhënia e dokumenteve të ofertës

Pas rekomandimit për kontratë të OE **UP LIFT**, ne kemi parashtruar kërkesë për qasje në dokumentacionin e ofertës së OE të rekomanduar, me qëllim të verifikimit të ligjshmërisë së procesit të vlerësimit dhe përmbushjes së kërkesave të Dosjes së Tenderit.

Kërkesa për qasje në dokumentacion është parashtruar **të premtën**, mirëpo deri **ditën e fundit për kërkesë për rsiqhyrtim(e martë)**, Autoriteti Kontraktues ende nuk na ka dërguar dokumentacionin e plotë të kërkuar.

Kjo vonesë dhe mosdhënie e dokumentacionit të plotë na ka kufizuar në mënyrë të drejtpërdrejtë mundësinë për ta analizuar ofertën e OE të rekomanduar dhe për ta ushtruar në mënyrë efektive të drejtën për kërkesë për rishqyrtim brenda afateve ligjore.

Nga dokumentacioni i pjesshëm i dërguar nga Autoriteti Kontraktues rezulton se mungojnë dokumente të rëndësishme të ofertës së OE **UP LIFT**, përfshirë:

1. **Sigurimi i dosjes së tenderit;**
2. **Certifikatat, Standardet dhe Pajisja për matje të Litarëve;**
3. **Pajisjet dhe sistemi i menaxhimit.**

OE **UP LIFT** ka dorëzuar kërkesë për konfidencialitet, mirëpo në atë kërkesë janë përmendur vetëm:

- **Lista e Stafit Profesional;**
- **Certifikatat.**

Pra, kërkesa për konfidencialitet nuk i përfshin të gjitha dokumentet që Autoriteti Kontraktues nuk na i ka dërguar, dhe me këtë veprim AK ka fshehur dokumentacion të OE edhe pa e pasur në kërkesë për sekret afarist.

Për më tepër, edhe për dokumentet e përmendura në kërkesën për konfidencialitet, OE **UP LIFT** nuk ka paraqitur fakte dhe argumente konkrete se si zbulimi i tyre do t'i shkaktonte dëm material biznesit të tij. Në formular është shënuar vetëm në mënyrë të përgjithshme se “dëmet të përcaktohen me ekspertizë financiare”, pa dhënë arsytim konkret dhe pa paraqitur ndonjë dëshmi për dëmin e pretenduar material.

Sipas **pikës 7.6.1 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik**, Autoriteti Kontraktues nuk do të klasifikojë një informatë si sekret afarist nëse OE nuk e ka plotësuar Aneksin 3 të Dosjes së Tenderit me të gjitha informacionet e kërkuara në formular, veçanërisht nëse nuk i ka paraqitur faktet dhe argumentet me të cilat dëshmon se zbulimi i informacionit do t'i shkaktonte dëm material biznesit të tij.

Në këtë rast, kërkesa për konfidencialitet nuk është plotësuar dhe nuk është arsyetuar sipas kërkesave të Rregullores. Prandaj, Autoriteti Kontraktues nuk ka pasur bazë ligjore për t'i klasifikuar këto dokumente si sekrete afariste.

Gjithashtu, Autoriteti Kontraktues nuk ka pasur të drejtë të fshehtë dokumente të tjera që nuk janë përfshirë fare në kërkesën për konfidencialitet të OE **UP LIFT**.

Mosdhënia e dokumentacionit të plotë, përkundër kërkesës sonë të parashtruar të premtën, përbën kufizim të qasjes në dokumente zyrtare dhe cenim të parimit të transparencës. Kjo na ka dëmtuar në përgatitjen e plotë të kërkesës për rishqyrtim, pasi pa qasje në dokumentacionin e plotë nuk mund të verifikohet nëse OE i rekomanduar ka përmbushur kërkesat teknike, profesionale dhe administrative të Dosjes së Tenderit.

Për këtë arsye, kërkojmë që Autoriteti Kontraktues të veprojë në pajtim me LPP-në dhe Rregulloren për Prokurimin Publik, duke na dërguar menjëherë dokumentacionin e plotë të ofertës së OE **UP LIFT**, përveç atyre dokumenteve për të cilat ekziston një kërkesë e vlefshme, e plotësuar në mënyrë të rregullt dhe e arsyetuar konkretisht për konfidencialitet.

PRETENDIMI 4) Mosdëshmimi i posedimit apo të drejtës së

shfrytëzimit të dinamometrit

Në Dosjen e Tenderit, te **Kërkesa 8**, është kërkuar që OE të posedojë gjatë kohës së servisimit dhe mirëmbajtjes **dinamometër për matjen dhe**

regjistrimin e litarëve të ashensorëve, me certifikatë valide.

Si dëshmi është kërkuar që OE ta dëshmojë dinamometrën përmes:

- **faturës;**
- **DUD-it doganor mbi blerje; ose**
- **kontratës për marrje në shfrytëzim gjatë kohës së servisimit.**
-

Nga dokumentet e dorëzuara nga OE **UP LIFT**, rezulton se janë dorëzuar vetëm DUD-i doganor dhe certifikata e pajisjes. Mirëpo, DUD-i doganor është në emër të kompanisë **LIFT TECH SH.P.K.**, jo në emër të OE **UP LIFT**.

Kjo nënkupton se OE **UP LIFT** nuk e ka dëshmuar pronësinë mbi pajisjen. Nëse pajisja është në pronësi të një subjekti tjetër, atëherë OE **UP LIFT** është dashur të dorëzojë kontratë/marrëveshje për marrje në shfrytëzim të dinamometrit gjatë kohës së servisimit.

Një marrëveshje e tillë nuk është dorëzuar.

Certifikata e pajisjes mund të dëshmojë vlefshmërinë teknike të pajisjes, por nuk dëshmon që OE **UP LIFT** e posedon apo ka të drejtë ta përdorë atë për këtë kontratë.

Prandaj, DUD-i në emër të **LIFT TECH SH.P.K.** nuk e përmbush kërkesën e Dosjes së Tenderit. Ai dëshmon importimin/pronësinë e pajisjes nga një kompani tjetër, por nuk dëshmon disponimin apo të drejtën e përdorimit nga OE **UP LIFT**.

Kjo është mangësi substanciale, sepse lidhet me kapacitetin teknik të OE për zbatimin e kontratës. Kjo mangësi nuk mund të plotësohet më vonë, pasi dorëzimi i një marrëveshjeje të re pas afatit për tenderim do të përbënte plotësim substancial të ofertës.

Prandaj, AK është dashur të konstatojë se OE **UP LIFT** nuk e ka përmbushur Kërkesën 8 dhe oferta e tij është dashur të shpallet e papërgjegjshme.

PRETENDIMI 5) Oferta financiare me çmime jo-normalisht të ulëta

Nga krahasimi i ofertës financiare të OE **UP LIFT** me ofertën tonë, rezulton se oferta e OE **UP LIFT** është dukshëm më e ulët.

Sipas rekapitullimit financiar:

Oferta e OE UP LIFT: 1,952.68 €

Oferta jonë: 3,939.09 €

Diferenca: 1,986.41 €

Oferta e OE UP LIFT është 50.43% më e lirë se oferta jonë.

Disa dallime konkrete në pozicione kryesore:

Kontrolleri kryesor / Pano elektrike

UP LIFT: 141.60 €

Oferta jonë: 480.00 €

UP LIFT është 70.50% më lirë

Inverter frekuencor deri 7.5 kW

UP LIFT: 318.60 €

Oferta jonë: 1,480.00 €

UP LIFT është 78.47% më lirë

Sistemi i evakuimit emergjent

UP LIFT: 53.10 €

Oferta jonë: 290.00 €

UP LIFT është 81.69% më lirë

Riparim/mbështjellje e motorit të ashensorit

UP LIFT: 59.00 €

Oferta jonë: 490.00 €

UP LIFT është 87.96% më lirë

Pajisja e thirrjeve urgjente nga kabina EN 81-28

UP LIFT: 141.60 €

Oferta jonë: 488.72 €

UP LIFT është 71.03% më lirë

Sistemi i menaxhimit të ashensorëve në distancë, përfshirë SIM kartelën

UP LIFT: 41.30 €

Oferta jonë: 600.00 €

UP LIFT është 93.12% më lirë

Inspektimi periodik çdo 12 muaj nga trupat e autorizuar

UP LIFT: 118.00 €

Oferta jonë: 280.00 €

UP LIFT është 57.86% më lirë

Duke marrë parasysh se këto pozicione përfshijnë furnizim, montim, përgjegjësi teknike dhe garancion 24 mujor, këto çmime janë dukshëm më të ulëta dhe është dashur të trajtohen nga AK si çmime potencialisht jo-normalisht të ulëta.

Prandaj, AK është dashur të kërkojë sqarime të detajuara nga OE **UP LIFT** para se ta rekomandojë për kontratë.

Duke u bazuar në faktet, provat dhe pretendimet e paraqitura në këtë ankesë, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që, pas shqyrtimit të lëndës, të nxjerrë këtë:

AKTVENDIM

Aprovohet si e bazuar ankesa e Operatorit Ekonomik EJONA SH.P.K., e parashtruar kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues Spitali Regjional – Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit:

“Mirëmbajtja e rregullt dhe servisimi i ashensorëve në Spitalin e Përgjithshëm të Prizrenit”

Nr. i prokurimit: 220/70010-26-1932-2-1-1

Nr. i brendshëm: 70010-26-001-2-1-1

Anulohet vendimi/njoftimi i Autoritetit Kontraktues për rekomandim të kontratës për OE UP LIFT L.L.C., si i kundërligjshëm dhe i pabazuar në dokumentacionin e dorëzuar.

Lënda kthehet në rivlerësim, me detyrim për Autoritetin Kontraktues që të bëjë rivlerësim të plotë, objektiv dhe të ligjshëm të ofertës së OE UP LIFT L.L.C., në raport me të gjitha kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe pretendimet e ngritura në këtë ankesë.

Obligohet Autoriteti Kontraktues që ofertën e OE UP LIFT L.L.C. ta shpallë të **papërgjegjshme**, për shkak të mosdëshmimit të përmbushjes së kërkesave minimale kualifikuese, dhe të vazhdojë me vlerësimin e ofertave të tjera të përgjegjshme. Obligohet Autoriteti Kontraktues që operatorëve ekonomikë të interesuar t’u sigurojë qasje në dokumentacionin e ofertës së OE të rekomanduar, në pajtim me LPP-në dhe Rregulloren për Prokurimin Publik, duke mos klasifikuar si konfidenciale dokumentet për të cilat nuk ekziston arsyetim konkret dhe i bazuar për dëmin material. Obligohet Autoriteti Kontraktues që të vazhdojë procedurën e prokurimit vetëm pas rivlerësimit të ligjshëm dhe në përputhje me vendimin e OSHP-së.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t’i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

DËMET MATERIALE

Me veprimet dhe mosveprimet e Autoritetit Kontraktues gjatë fazës së vlerësimit dhe rekomandimit për kontratë, operatori ynë ekonomik është dëmtuar dhe rrezikon të dëmtohet materialisht, pasi që është pamundësuar trajtimi i drejtë, transparent dhe i

barabartë i ofertës sonë.

Dëmet materiale konsistojnë në:

1. ****Humbjen e mundësisë reale për fitimin e kontratës****, për shkak se AK ka rekomanduar për kontratë OE ****UP LIFT****, edhe pse sipas pretendimeve tona ky operator nuk i ka përmbushur kërkesat minimale të Dosjes së Tenderit.
2. ****Dëmtimin financiar nga mosdhënia e kontratës****, pasi në rast të vlerësimit të drejtë dhe eliminimit të ofertës së papërgjegjshme, oferta jonë do të mund të merrej në konsideratë për dhënie të kontratës.
3. ****Shpenzimet e përgatitjes dhe dorëzimit të ofertës****, duke përfshirë kohën e stafit profesional, dokumentacionin administrativ, përgatitjen teknike dhe financiare, sigurimin e tenderit dhe angazhimet tjera të nevojshme për pjesëmarrje në këtë aktivitet të prokurimit.
4. ****Dëmtimin e konkurrencës së drejtë****, pasi pranimi i dokumenteve të paplota, të pavlefshme ose të paverifikueshme të OE të rekomanduar ka krijuar pozitë të pafavorshme për operatorët ekonomikë që kanë përgatitur ofertën në përputhje me të gjitha kërkesat e Dosjes së Tenderit.
5. ****Rrezikun e humbjes së të hyrave të pritshme nga kontrata****, pasi vlera e kontratës dhe kohëzgjatja e saj krijojnë pritje të arsyeshme për të ardhura nga shërbimet e mirëmbajtjes, servisimit dhe furnizimit me pjesë gjatë periudhës së kontratës.
6. ****Dëmin nga kufizimi i qasjes në dokumente****, sepse kërkesa për qasje në dokumentacionin e ofertës së OE të rekomanduar për kontratë është parashtruar të premtën, ndërsa deri sot, ditë e martë, dokumentacioni i plotë nuk na është dërguar. Kjo vonesë dhe mosdhënie e dokumentacionit na ka pamundësuar verifikimin e plotë të ligjshmërisë së vlerësimit dhe ushtrimin efektiv të së drejtës për rishqyrtim brenda afateve ligjore.
7. ****Dëmin nga zvarritja e procedurës****, pasi ne detyrohemi të shpenzojmë kohë dhe mjete shtesë për përgatitjen e kërkesës për rishqyrtim dhe, eventualisht, ankesës pranë OSHP-së, për shkak të gabimeve në vlerësim dhe mungesës së transparencës nga Autoriteti Kontraktues.

Prandaj, dëmi material nuk kufizohet vetëm në shpenzimet direkte të pjesëmarrjes në tender, por përfshin edhe humbjen e mundësisë reale për kontraktim, humbjen e të hyrave të pritshme, kufizimin e qasjes në dokumente dhe shpenzimet shtesë që operatori ynë ekonomik detyrohet t'i bartë për mbrojtjen e të drejtave të tij në këtë aktivitet të prokurimit.

Duke qenë se kontrata është rekomanduar për një operator ekonomik që, sipas pretendimeve tona, nuk ka dëshmuar përmbushjen e kërkesave minimale kualifikuese, kërkojmë që AK të marrë parasysh dëmet materiale të shkaktuara dhe të parandalojë dëmtimin e mëtejshëm përmes anulimit të rekomandimit për kontratë dhe kthimit të lëndës në rivlerësim.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t’ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t’ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*